




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-10197/19 datë:16.04.2019



Npi – 01/184 datë: 31.08.2020

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën me numër: Nr.01-070/05-6235/20 datë:09.03.2020, të z.Sali Beqaj nga fshati Petrovë, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes ka kërkuar që të gjej një zgjidhje për pronën që e kemi në Davidovc me Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, me sipërfaqe prej 1 hektar e 2 ari, pasi që nga viti 2007 nuk po mundemi, që ta shfrytëzojmë për shkak të pengesave nga banorët e fshatit Davidovc. Ne nga Kuvendi po kërkojmë të na bëj një zgjidhje duke e ndërruar pronën, apo lëvizjen e pronës pak më tutje, ndërrimin komplet të pronës ose kompensimin e sajë.

Kuvendi i Komunës, duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) dhe 17 pikat (c dhe f) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr 28/2008); Pasi që diskutoi për kërkesën e palës, dhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë e Financa, aprovoi këtë:

KONKLuzion

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VI- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më 31.08.2020, me shumicën e votave vendosi që kërkesa me numër: Nr.01-070/05-6235/20 datë:09.03.2020, e z.Sali Beqaj nga fshati Petrovë, të shtyhet për shqyrtim, deri në mbledhjen e radhës, me arsyetimin që të plotësohet me informata shtesë.

II

Konkluzioni u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj